

Vendim nr. 61 datë 20.11.2023

(V61/23)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 20.11.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (M) 2023 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: **MAJLINDA REXHA**, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga av. Irena Dule

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

AFËRDITA TOSKA,
ENKELEDA TOSKA,
ARTJOLA TOSKA,
ORION TOSKA

OBJEKTI: **Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe gjykimi i çështjes me procedurë të përshpejtuar.**
Shfuqizimi i vendimit nr. 13, datë 06.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, pika 2, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Majlinda Rexha, së bashku me disa bashkëtrashëgimtarë të tjerë, ka ngritur padi në gjykatë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së datës 15.01.1978 për dhurimin e pasurisë trashëgimore (një shtëpi banimi në Tiranë) dhe të kontratës së datës 15.01.1978 për pjesëtimin e saj, si dhe fshirjen e regjistrimeve të veprimeve juridike të kryera mbi të. Shkaku ligjor i ngritjes së padisë lidhet me vendimin nr. 2950, datë 23.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 822, datë 17.08.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është konstatuar pavlefshmëria e pjesshme e testamentit të datës 16.01.1968 dhe janë ripërcaktuar trashëgimtarët e trashëgimlënësit, midis tyre edhe kërkuesja.

2. Çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 10.06.2016. Gjatë këtij procesi, i padituri Ismail Toska ka kërkuar pezullimin e gjykimit, duke parashtruar se kishte nisur një proces gjyqësor paralel, me objekt ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. 2950, datë 23.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pavlefshmërinë e testamentit, në të cilin ishte thirrur në cilësinë e personit të tretë edhe kërkuesja. Në këto rrethana, në datën 18.11.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e procesit gjyqësor për ndreqjen e gabimeve materiale.

3. Për këtë të fundit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 57, datë 03.07.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 903, datë 03.04.2018. I padituri Ismail Toska, që kishte vënë në lëvizje procesin gjyqësor të ndreqjes së gabimeve materiale, ka paraqitur rekurs dhe prej datës 13.07.2018 çështja është në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

4. Në datën 08.04.2022 kërkuesja, bazuar në nenin 399/5 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit të rekursit që i përket çështjes gjyqësore për ndreqjen e gabimeve. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 13, datë 06.06.2022, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se është në pamundësi objektive për procedimin e menjëhershëm për shqyrtimin e çështjes.

5. Kërkuesja në datën 21.03.2023 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Në datën 31.05.2023 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, duke thirrur si subjekt të interesuar në proces Ismail Toskën.

6. Nga procedura e njoftimit të palëve u konstatua se subjekti i interesuar Ismail Toska kishte ndërruar jetë. Mbledhja e Gjyqtarëve, pasi shqyrtoi certifikatën e vdekjes nr. 41, datë 13.02.2020 dhe vendimin e noterit “Për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1065 Rep., Nr. 822 Kol., datë 06.08.2020”, në datën 18.09.2023, bazuar në nenin 199 të KPC-së, vendosi kalimin procedural tek trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit (bashkëshortja dhe tre fëmijët), duke i thirrur ata në gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë ka mbi 4 vjet e gjysmë që nuk po përfundon dhe kjo vonesë po zvarrit gjykimin e themelit të çështjes për pavlefshmërinë e kontratës së dhurimit.

7.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë e ka kthyer në standard arsyetimin se çdo vonesë e shkaktuar si rrjedhojë e reformës në drejtësi nuk përbën shkelje të afatit të arsyeshëm, por shkak të njohur dhe mbrojtur nga ligji.

7.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, në drejtim të gëzimit, posedimit dhe disponimit të saj, si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimitimin e kërkueses*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, e 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të

pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se kërkesja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata, pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të neneve 399/5 - 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar në atë gjykatë, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Civil me vendimin nr. 13, datë 06.06.2022. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkueses për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

12. Lidhur me afatin e paraqitjes së ankimit, Gjykata, bazuar në informacionin zyrtar të lëshuar nga Gjykata e Lartë, konstaton se vendimi për rrëzimin e kërkesës për përshpejtim i është komunikuar kërkueses në datën 22.11.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 21.03.2023. Në këto rrethana, Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi shkelja e pretenduar është vazhduese dhe ankimi, pas shterimit të mjetit juridik në dispozicion, është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së ndreqjes së gabimeve materiale, të regjistruar në Gjykatën e Lartë, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të

planifikuar për shqyrtimin e rekursit. Gjykata vëren se kërkesja ka ngritur edhe pretendime për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë dhe së drejtës së pronës, por këto pretendime lidhen me vonesat në shqyrtimin e çështjes së ndreqjes së gabimeve, që ka shkaktuar pezullimin e gjatë të çështjes së themelit. Për rrjedhojë, Gjykata do t'i analizojë pretendimet e kërkueses vetëm në këndvështrim të vlerësimit të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor të kundërshtuar, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

14. Kërkesja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi rekursi në Gjykatën e Lartë ka mbi 4 vjet e gjysmë që nuk shqyrtohet, duke tejkaluar afatin kohor të arsyeshëm. Çështja e ndreqjes së gabimeve materiale është regjistruar në Gjykatën e Lartë në vitin 2018 dhe ende është në fazë studimi. Arsyetimi i Gjykatës së Lartë në vendimin që ka rrëzuar kërkesën për përsheptim bie ndesh me Kushtetutën, pasi vonesa e shqyrtimit të rekursit ka shkaktuar zgjatjen e pezullimit prej 6 vjetësh të çështjes tjetër gjyqësore për pavlefshmërinë absolute të kontratës së dhurimit, duke dëmtuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës së kërkueses.

15. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

16. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se thelbi i mosmarrëveshjes që po gjykohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës dhe gjykimi i saj është pezulluar deri në përfundimin e çështjes gjyqësore për ndreqjen e gabimeve materiale. Kjo e fundit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 13.07.2018 dhe ndonëse kanë kaluar 5 vjet, ende nuk ka një vendimmarrje për të. Duke iu referuar objektit të mosmarrëveshjes gjyqësore, Gjykata vëren se neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së ka përcaktuar se përbën afat të arsyeshëm përfundimi i gjykimit civil në Gjykatën e Lartë brenda dy vjetëve. Kjo do të thotë se gjykimi i çështjes konkrete në Gjykatën e Lartë është tejzgjatur, ndaj për të vlerësuar nëse kohëzgjatja e saj është e paarsyeshme, pra nëse

kërkueses i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e interesit që rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuesit

17. Sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se kërkuesja, pasi ka pritur dhe ka konstatuar se nuk ishte planifikuar një datë për shqyrtimin e rekursit në çështjen e ndreqjes së gabimeve materiale, i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 08.04.2022 për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së. Kjo kërkesë është rrëzuar nga Gjykata e Lartë në datën 06.06.2022 dhe sërish çështja ka mbetur pa veprime, në pritje të planifikimit për një datë shqyrtimi. Kërkuesja, pasi është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë, ka paraqitur ankim kushtetues individual, sipas objektit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e kërkueses nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së saj.

ii. Kompleksiteti i çështjes

19. Kërkuesja pretendon se çështja nuk paraqet kompleksitet, ajo është një çështje procedurale dhe pretendimet e palës në rekurs lidhen me llogaritjen e pjesëve takuese në pasurinë trashëgimore.

20. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objekti, faktet e kundërshtuara, volumi dhe natyra e provave, lloji dhe ndërthurja e ligjeve të zbatueshme, si dhe numri i palëve pjesëmarrëse në proces. Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, sepse balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i takon gjykimit në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se ai nuk paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera, për shkak të natyrës dhe

procedurës së gjyimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit (*shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se edhe pse në gjykim janë thirrur një numër jo i vogël palësh ndërgjyqëse, që përkon me numrin e trashëgimtarëve të pasurisë, në thelb, çështja e ndreqjes së gabimeve materiale ka natyrë procedurale civile. Ajo ka vetëm një kërkim në objektin e saj – atë për ndreqjen e gabimit të vendimit gjyqësor përfundimtar bazuar në dispozitat e KPC-së dhe të Kodit Civil. Ky kërkim përfshin verifikimin formal të vendimit gjyqësor përfundimtar dhe numrit të trungjeve të trashëgimtarëve, në raport me pretendimin për përllogaritje të gabuara, që ka shkaktuar përcaktimin e pasaktë të pjesëve të pasurisë trashëgimore. Gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit janë shprehur me vendim rrëzimi për kërkesën për ndreqje gabimi material, me arsyetimin e njëjtë se pretendimet nuk kishin të bënin me gabimet materiale, por lidheshin me themelin e mosmarrëveshjes së zgjidhur me vendim gjyqësor përfundimtar. Gjithashtu, Gjykata vëren se në rekurs janë ngritur pretendime që lidhen me arsyetimin e gjykatave më të ulëta, që sipas rekursuesit është cilësuar i gabuar dhe favorizues për palën kundërshtare.

22. Duke iu referuar aspekteve të mësipërme, Gjykata çmon se çështja e kërkuarës nuk paraqitet komplekse që të justifikojë kohëzgjatjen e shqyrtimit të saj prej 5 vjetësh.

iii. Sjellja e autoriteteve

23. Kërkuarja ka parashtruar se Gjykata e Lartë e ka rrëzuar kërkesën e saj për konstatimin e shkeljes dhe përsheptimin e procedurave, duke kthyer në standard arsyetimin se çdo vonesë e shkaktuar si rrjedhojë e reformës në drejtësi nuk përbën shkelje të afatit të arsyeshëm, por shkak të njohur dhe mbrojtur nga ligji.

24. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjyimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Pa mohuar nevojën, rëndësinë dhe përfitimet që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, Gjykata ka theksuar se ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjyimit të çështjeve, nëse edhe masa të tilla nuk rezultojnë efektive dhe tejzgjatja e procedurave kthehet në problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të ndërhyjë me miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë

që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një afati të arsyeshëm (shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 37, datë 05.11.2021; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Në këtë kuptim, shteti është përgjegjës për të gjitha autoritetet shtetërore, përfshirë organet gjyqësore, sepse neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së kërkojnë që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, duke vënë theksin në parimin e përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë. Megjithatë, një mbingarkesë kronike nuk mund të justifikojë zgjatjen e tepërt të procedurave. Nëse një situatë e tillë zgjatet dhe bëhet çështje organizimi strukturor, metoda të tilla nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efektive. Fakti që situata të tilla me çështje të prapambetura janë bërë të zakonshme, nuk justifikon zgjatjen e tepërt të procedurave (shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

26. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se shqyrtimi i rekursit të çështjes së kërkuësës është ende për shqyrtim prej 5 vjetësh pa vendimmarrje në Gjykatën e Lartë, duke shkaktuar tejzgjatjen e pezullimit të gjyqimit të mosmarrëveshjes së kërkuësës për kërkimin e pasurisë trashëgimore në shkallë të parë. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave, duke vlerësuar se është në pamundësi objektive të përshpejtojë gjykimin. Ajo pranon se çështja nuk është komplekse dhe se kërkuësja nuk është bërë shkak vonese me sjelljen e saj, duke evidentuar njëkohësisht se asaj nuk i vjen ndonjë rrezik i veçantë nga mosgjykimi në afat i çështjes dhe se në veprimtarinë e gjykatës nuk vihet re ndonjë pakujdesi. Në arsyetimin e vendimit të saj Gjykata e Lartë ka interpretuar konceptin “*pamundësi objektive*” të nenit 399/2 të KPC-së, duke përfshirë në të gjendjen e sistemit të drejtësisë për shkak të reformimit të tij, që ka shkaktuar uljen e numrit të gjyqtarëve dhe rritjen e ngarkesës së punës në gjykata dhe ka konkluduar se vonesat për shkak të reformës janë proporcionale në raport me të mirën e përgjithshme që krijon procesi i reformës (shih paragrafët 17, 18, 22 dhe 32 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

27. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata, duke bërë një vlerësim të natyrës kushtetuese, ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve (shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

28. Për sa më lart, Gjykata, duke njohur kompetencën kushtetuese të Gjykatës së Lartë për interpretimin e ligjit sipas nenit 141 të Kushtetutës, çmon se duhet kontrolluar nëse

interpretimi që ajo i ka bërë nenit 399/2 të KPC-së ka respektuar standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor, në aspektin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë kontekst, Gjykata eidenton se argumenti kryesor, i cili qëndron në thelb të interpretimit ligjor të Gjykatës së Lartë për “*pamundësinë objektive*”, lidhet me efektet e zbatimit të reformës në drejtësi në drejtim të volumit të lartë të çështjeve që po përballon sistemi i drejtësisë, përfshirë Gjykatën e Lartë.

29. Duke analizuar gjendjen e Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se në datën 13.07.2018, kur çështja e kërkuases është regjistruar, reforma në drejtësi kishte filluar të zbatohet. Në fund të vitit 2018 numri i çështjeve të mbartura ishte 28 863, ndërsa funksionimi i saj efektiv mbështetej vetëm në 3 anëtarë nga 19 anëtarë (*shih faqen 42 të raportit “Mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësorë për vitin 2018”*). Në datën 24.10.2023, teksa reforma është ende në proces zbatimi dhe çështja e kërkuases vijon pa vendimmarrje, numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është rritur në 18 anëtarë. Gjykata e Lartë informon me shkrim se ngarkesa e çështjeve është deri në 4 292 çështje për çdo gjyqtar të Kolegjit Civil. Ngarkesa e gjyqtarit relator, të cilit i është caktuar për shqyrtim çështja e kërkuases, në datën 23.10.2023, ka shkuar në 2 259 çështje për shqyrtim. Çështjet gjyqësore janë vënë në lëvizje në rend kronologjik, duke filluar nga çështjet e regjistruara më herët dhe Kolegji Civil po shqyrton ato të regjistruara në vitin 2015. Kohëzgjatja mesatare e gjykimit për këtë kolegji është 8 vjet. Po ashtu, Gjykata e Lartë informon se ajo ka për shqyrtim 47 çështje të ngjashme me ato të kërkuases (për të tre kolegjet), pra që lidhen me ndreqjen e gabimeve dhe se ajo me e hershmja është regjistruar në vitin 2015.

30. Duke i analizuar treguesit e mësipërm, Gjykata çmon se vonesa në gjykimin e çështjes së kërkuases është pasojë e ngarkesës së lartë në Gjykatën e Lartë dhe të gjyqtarit relator, të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Kjo ngarkesë është duke zgjatur prej disa vitesh dhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se, ashtu siç pohon edhe Gjykata e Lartë në vendimin e saj, “*mekanizmat e parashikuara nga nenet 399/1-399/12 i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore*” (*shih paragrafin 26 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë.

31. Gjykata vëren se gjykimi përtej afatit të arsyeshëm, bazuar vetëm në faktin se shteti ka dështuar të marrë masa efikase, nuk mund të përligjë cenimin e të drejtave kushtetuese të individëve, në kushtet kur mbingarkesa në gjykata tashmë është një situatë e njohur dhe e zgjatur në kohë, e cila nuk varet nga individët. Në këtë pikë, Gjykata eidenton se sjellja e autoriteteve shtetërore, në veçanti e atyre që miratojnë ligjet dhe politikat e sistemit të

drejtësisë, nuk është në nivelin e duhur të efikasitetit, pasi bën të nevojshme ndërhyrje të mëtejshme, veçanërisht legjislative, për të shmangur vonesat e paarsyeshme të gjykimit të çështjeve në gjykata, në kushtet kur mjetet ligjore ekzistuese nuk i përgjigjen situatës aktuale. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në standardet kushtetuese të mësipërme, vlerëson se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave të shqyrtimit të rekursit në çështjen e kërkuar nuk është në përputhje me Kushtetutën, ndaj vendimi i saj duhet shfuqizuar.

iv. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar

32. Kërkuarja pretendon se vonesa e shqyrtimit të çështjes gjyqësore për ndreqjen e gabimeve ka shkaktuar zgjatjen e pezullimit prej 6 vjetësh të çështjes tjetër gjyqësore për pavlefshmërinë absolute të kontratës së dhurimit, duke dëmtuar në këtë mënyrë të drejtën e pronës së saj.

33. Gjykata ka pohuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret parasysh çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuarit në procesin gjyqësor, pra rëndësia që ka për kërkuarin e drejta objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë. Lista e këtyre çështjeve nuk mund të jetë shteruese dhe verifikimi i kriterit të interesit të kërkuarit në proces verifikohet nga Gjykata rast pas rasti (*shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se çështja gjyqësore për ndreqjen e gabimeve materiale është ende në pritje për t’u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë sipas rendit kronologjik të regjistrimit të saj. Ndërkohë, Gjykata e Lartë ka në shqyrtim 47 çështje të tilla, që në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve, nuk përbën volum të lartë. Gjykata evidenton se çështjet me objekt ndreqje gabimi janë vlerësuar nga KLGj-ja me natyrë specifike dhe duhet të shqyrtohen shpejt për të shmangur pasojat e rënda për palët në proces dhe për dhënien e drejtësisë (*shih kreun II, pika 3, nënpika 3.1., shkronja “e”, të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 të KLGJ-së “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”*), dhe kur çështja ka shkaktuar pezullimin e gjykimit të një çështjeje tjetër gjyqësore përbën shkak veçanërisht të rëndë që motivon shqyrtimin e përshpejtuar të saj (*shih pikën 6, shkronja “c”, po aty*).

35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vonesa e shqyrtimit të rekursit për çështjen e ndreqjes së gabimeve materiale ndikon drejtpërdrejt në zgjatjen e pezullimit të shqyrtimit të mosmarrëveshjes për të drejtën e bashkëpronësisë dhe ndarjes së pjesëve takuese mes

trashëgimtarëve. Gjykimi i kësaj mosmarrëveshjeje është pezulluar që prej datës 18.11.2016, pra prej 7 vjetësh në gjykatën e shkallës së parë. Në këtë drejtim, duhet vënë në dukje rëndësia e së drejtës së pronës, e cila përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr. 1, datë 06.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se çështja është e një natyre të tillë që vonesa në shqyrtimin e rekursit sjell dëm jo vetëm për kërkuesen, por për të gjitha palët e përfshira në mosmarrëveshje.

36. Në përfundim, duke pasur parasysh kohëzgjatjen prej 5 vjetësh të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, kompleksitetin e ulët të çështjes, sjelljen e autoriteteve, si dhe rëndësinë e së drejtës së pronës, Gjykata vlerëson se kërkueses i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit, ndaj kërkesa duhet të pranohet. Po ashtu, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 dhe duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e punës së Gjykatës së Lartë, si dhe volumin e çështjeve të ngjashme me ato të kërkueses (*shih paragrafin 28 më sipër*), Gjykata çmon se duhet urdhëruar shqyrtimi i rekursit të çështjes së kërkueses me përparësi, pa pritur radhën sipas kohës së regjistrimit të saj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 13, datë 06.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë të shqyrtojë çështjen e kërkueses me përparësi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 20.11.2023

Shpallur më 13.12.2023